



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština/Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



1

PROCESVERBALI

Mbledhja e Komitetit për Komunitete të Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur me datë: **10.03.2021** me fillim në ora **10.00**. Këtë mbledhje e kryesoi kryesuesi i Komitetit për Komunitete **z. Bajram Morina**. **Kryesuesi** – Fillimisht më lejoni të ju përshëndes të gjithëve për praninë tuaj në këtë mbledhje të Komitetit për Komunitete, përshëndetje për nënkryetarin **z. Fatmir Iska**, përfaqësues të KFOR-it, të OSBE-së. Pasi që është edhe takimi i parë i radhës për vitin 2021, ju dëshiroj punë të mbarë dhe suksese. Në këtë takim, propozoj këtë rend dite:

REND DITE

- 1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i respektimit të gjuhëve zyrtare në Komunën e Rahovecit,**
- 3. Shqyrtimi i investimeve kapitale nga Komuna e Rahovecit në vendbanimet e banuara me komunitete jo shumicë,**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi –Të nderuar anëtarë, para se me qitë rendin e ditës në votim a keni diçka për të shtuar, nëse jo atëherë e qes në votim rendin e ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës.

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

A ka dikush diçka rreth Procesverbalit të kaluar, atëherë nëse jo e qesim në votim. Konstatohet se unanimisht aprovohet Procesverbali nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i respektimit të gjuhëve zyrtare në Komunën e Rahovecit.

Sa i përket kësaj pike rreth respektimit të gjuhëve zyrtare në Komunën e Rahovecit nuk kemi ndonjë ankesë apo vërejtje rreth respektimit të gjuhëve zyrtare. Kështu që kalojmë në pikën e radhës.

3. Shqyrtimi i investimeve kapitale nga Komuna e Rahovecit në vendbanimet e banuara me komunitete jo shumicë.

Lendrit Qeli – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, të nderuar të pranishëm. Meqenëse zyra komunale për komunitete edhe kthim në bashkëpunim me drejtorinë e shërbimeve publike është vazhdimisht përkitazi njëri tjetrit kur kemi të bëjmë me infrastrukturën dhe çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet jo shumicë. Meqenëse ne kemi raportuar në këtë drejtim por vetëm po ju riinformoj dhe ne të njëjtën kohë po ju informoj për projektet e radhës që priten me qenë pjesë e investimeve kapitale për komunitete jo shumicë. Në ditët në vazhdim ne jemi vetëm në pranimin teknik të investimeve që i kemi pas ne renovimin e rrugëve dhe rrugicave në lagjen e epërme, pastaj kemi renovimin edhe kubëzimin e rrugës në fshatin Xërxe, pastaj në fshatin Hoxhë dhe Çifllak. Në kuadër të këtyre katër mbështetje për katër rrugicat parashihet që shumë shpejt të dërgohen edhe kontejnerët që kanë qenë kërkesë e vazhdueshme edhe e komitetit por edhe e qytetareve atje. Kur jemi të investimet kapitale nënkuptohet edhe mbështetja në ndriçim që është bërë vendbanimeve nga radha e komuniteteve, që ato i kemi pasur në bashkëpunim me IOM-in, ku kemi ndriçimin në fshatin Hoçë dhe fshatin Krushë të Madhe dhe po ashtu në lagjen e epërme. Ndërsa projektet që priten të realizohen pothuajse këtë vitë, ne vetëm kemi nënshkruar një marrëveshje me IOM-in para disa ditëve dhe kryetarin e Komunës, ku pritet të investohet prapë në Krushë të Madhe në rrethimin e varrezave të komuniteteve dhe shumë shpejt presim të intervenojmë edhe në fshatin Hoçë gjegjësisht në qendrën kulturore atje ku ka nevojë të rinovohet kulmi komplet dhe po ashtu në fshatin

Brestoc ne hapësirën atje ku ballafaqohet me kanalizim një kohë të gjatë pjesëtarët e komuniteteve. Këto ditë kemi pasur komunikim edhe me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim dhe kemi kërkuar që të intervenohet edhe ne kanalizim ne pjesën e epërme ku vazhdimisht për shkak të gypave të ngushtë dhe kapacitetit që është rritë atje, është e pamundshme pastrimi dhe ne kemi kërkuar që komplet të intervenohet atje dhe i kemi dërguar drejtorisë së Shërbimeve Publike kërkesë që të bëhen matjet dhe parallogaritë ne total që ti drejtohem Ministrisë sepse kemi marr një sinjal prej tyre që do të mundën të intervenojnë ne atë pjesë. Po ashtu kur jemi te Ministria për komunitete dhe kthim, kemi marr një premtim se do të na bashkë financojnë edhe ne renovimin e varrezave ne qytet pas gjithë asaj që ndodhi para një periudhe ne rrënimin e varrezave të komuniteteve rom ashkali dhe egjiptian ne Rahovec. Ne kemi kërkuar që me qenë ne bashkëfinancim me Ministrin për Komunitete dhe Kthim, kështu që ata kanë shprehur dëshirën me na mbështetë mirëpo deri me tani nuk ende diçka konkrete, por presim ne ditët ne vazhdim nëse nuk kemi diçka do të intervenojmë ne si zyre. Për ndryshe ende nuk kemi ndonjë informatë apo organeve të rendit për me i gjetë personat që e kanë krye aktin. Unë u mundova përafërsisht me përcaktua këto që ne kemi planifikua bashke me drejtorin e Shërbimeve publike, kështu që nëse ka pyetje shtesë atëherë do të jem i hapur për përgjigje.

Ramë Berisha – Përshendte për të gjithë, nënkryetarin dhe gjithë anëtarët pjesëmarrës ne kete mbledhje. Kur u folë për investimet ne komunitetin joshumicë, por une do të thoja edhe për shumicë pasi të gjitha keto projekte janë të gjithë për qytetet e komunës së Rahovecit. Vitin e kaluar janë realizuar shume projekte për qytetet e komunës së rahovecit ku me iniciativën e zyrës për komunitete dhe kthim me z. Lendrit dhe bashkëpunëtorët e tij komunla dhe ato mjete I kanë shpenzuar ne infrastructure ne projekte të ndryshme, mirpo kanë mbetur edhe shume projekte tjera të mbetura ne infrastructure kështu që kërkojmë që edhe ato të realizohen që kam folur edhe mbledhjen e kaluar, pasi kemi një urë që ka mungesat e mbrojtësve që krijon rrezik për qytetet që kalojnë e veqanarisht për nxenesit që shkojnë ne shkolle. Kështu që kisha kërkuar që me u renovue sa me shpejt kjo urë që me parandalua ndonjë viktime si pasojë e mbrojtësve të urës. Gjithashtu edhe vitin e kaluar kam fol ne tubimet e bashkësisë lokale gjithashtu edhe edhe ne këtë sallë, kemi edhe një trotuar që shtrihet gjatë rrugës Elena Gjika nga tuneli e deri te shkolla Hamëz Thaqi ne Xerxe që është shume e nevojshme të bëhet ai trotuar për lëvizjen e nxënësve dhe qytetareve që e frekuentojnë këtë rrugë. Pra edhe kjo është prioritare pasi ne të gjitha fshatrat janë të rregulluara. Kështu që këto ishin disa nga kërkesat shume të nevojshme për qytetet ne përgjithësi.

Kryesuesi – Faleminderit z. Rame Berisha, unë kisha kërkuar nga ju që të parashtroni një kërkesë pranë zyrës për komunitete dhe kthim dhe ne bashkëpunim me drejtorin e shërbimeve publike do të mundohemi të bëjmë zgjidhje për ata kalimtarë dhe nxënës që frekuentojnë atë trotuar.

4. Të ndryshme.

Lendrit Qeli – Faleminderit kryesues, kam vetëm një informatë pasi kam pasur një takim me majorin Vojvoda dhe një zyrtari të lartë të NATO-s që pritët shume shpejt me u hap një konkurs për rekrut të ri dhe kadetë ne FSK, për të cilën inkurajohen pjesëtarët e komunitetit joshumicë dhe neve do të provojmë bashke me anëtarët e FSK-së që vetëm nëse na jepet mundësia për shkak të masave të Covidit të mbajmë edhe një fushatë ne këtë drejtim dhe të informojmë sa me shume pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë për mundësinë që kanë e sidomos për kadetë të ri që mundësia për me shkue ne Maqedoni të veriut apo ne Kroaci. Kjo është informatë që besoj është shume e nevojshme për të gjithë anëtarët e komitetit për Komunitete që me shpërndaje si informacion dhe ne të njëjtën kohë zyrtaret nga FSK dhe NATO me mision pranë monitorimit ne Kosovë kanë shume të gatshëm nëse është e mundshme një ditë edhe me ju takua personalisht edhe me ndae informatën bashke.

Kryesuesi – Faleminderit z. Qeli, atëherë meqë nuk kemi ndonjë sugjerim pyetje apo vërejtje, konstatoj se takimi është i mbyllur dhe shihemi ne takimin e radhës. Faleminderit për pjesëmarrje dhe kontributin tuaj.

Proçesmbajtësi

Agim Hoti

